

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 04.07.2022	Numri i vrojtimit të lejes:	07 Nr.351/350-35096
------------------	-----------------------------	---------------------

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Beslira Jasharaj nga Suhareka, Komuna Suharekë, me 07 Nr.350-35096 të datës 14.06.2022 - në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzimin e hapsirës publike, në bazë të nenit 5, 14 dhe 21 të Ligjit të ndërtimit Nr. 04/L-110 dt. 31 Maj 2012, nenit 56 dhe 57 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve 01Nr.-16-423 dt. 26.01.2011, nenit 8 alinea 8.9 pika 8.9.1 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015, nenit 5, 8, 9, 11, 12, 13 dhe 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016 si dhe Procesverbalit 07Nr.315/350-35096 të datës 22.06.2022, bie këtë:

P Ë L Q I M

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Beslira Islam Jasharaj	Nr. Personal	
Adresa:	Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim - për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një kioske nga druri.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - z. **Beslira Jasharaj** nga Suhareka, Komuna Suharekë, shfrytëzimi i hapsirës publike për vendosjen e një kioske nga druri (formë shanku) për shërbime të pijeve freskuese në sezonin veror, në një sipërfaqe prej **10.00m²**, në parcelën kadastrale Nr.798-0, pasuri shoqërore, në zonën kadastrale Suharekë, në rrugën “Brigada - 123“- vendi i quajtur sheshi “Ibrahim Rugova“, Komuna Suharekë.

Vendosja e kioskës nga druri (formë shanku) për shërbime të pijeve freskuese në sezonin veror, si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore - hapsirës publike - **lejohe me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **22.06.2022** deri më **31.08.2022**, me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore .

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë hapsirën publike në një sipërfaqe prej **10.00 m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **22.06.2022** deri më **31.08.2022** është gjithsejtë: **69.00 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër.

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohet të kufizohet (rrethohet) .

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar.

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës, ku lejohet shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të objektit të cituar më lartë, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e objektit në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit .

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektin e cekur më lartë ta menjanoni për një kohë të caktuar .

Nëse ka ankesa nga ana e fqinjëve përshkak të zhurmës apo pengesave tjera të arsyeshme të banorëve për rreth, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse investuesi nuk i vendos këto brenda afatit të cituar në këtë Pëlqim.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investuesit z. **Beslira Jasharaj** nga Suhareka, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohet vendosja e një kioske nga druri (formë shanku) për shërbime të pijeve freskuese në sezonin veror si dhe shfrytëzimi i pasurisë - hapësirës publike, në një sipërfaqe prej **10.00m²**, me afat të caktuar me këtë Pëlqim.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapësirës publike konform Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit .

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës :
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

